| NJOFTIM PUNËSIMI | |
|---|---|
| **Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK** | Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësojë për një vend pune**: Punëtor pranë Mirëmbajtjes së Rrjetit/Grumbullimi i Ujërave të Ndotura në Njësinë Operative Durrës** nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për të zbatuar detyrat dhe urdhrat e punës të dhëna nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura dhe kryen procesin e punës të caktuar prej tij. |
| **Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:** | • Punëtori varet nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura i NjO-së.<br>• Zbaton brenda kritereve të caktuara, të gjitha detyrat ditore që i ngarkohen nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura dhe raporton për realizimin e tyre.<br>• Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi i Grumbullimit të Ujërave të Ndotura dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.<br>• Zbaton në çdo kohë, sipas udhëzimeve të eprorëve rregullat dhe masat e sigurimit teknik në punë.<br>• Njofton Përgjegjësin e Grumbullimit të Ujërave të Ndotura, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tij.<br>• Është në gatishmëri edhe pas kohës së punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence. |
| **Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:** | • Eksperienca pune të mëparshme.<br>• Librezë e Punës<br>• Certifikatë Familjare<br>• Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës |

| | |
|---|---|
| | • Dy fotografi<br>• Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar<br>• Dëshmi Penaliteti<br>• Raporti Mjekësor<br>• Vërtetim Vendbanimi |
| **Kushtet e punës:** | • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur.<br>• Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani. |
| • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (dëftesë, certifikata, etj.) deri më datë 24.11.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. | |